



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1412, datë 23.09.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrative të, Sipërmarrësit Alternativë “Albanian Telecommunications Network” (ATN) sh.p.k, në lidhje me Aktet Administrative, Vendimi nr. 1345, 1346 dhe 1347 datë 23.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.09. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimimeve administrative të Sipërmarrësit Alternativë Alternativë “Albanian Telecommunications Network” sh.p.k (më poshte ATN sh.p.k) në lidhje me Aktet Administrative të Keshillit Drejtues të AKEP:

- **Vendimi nr.1345**, datë 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- **Vendimi nr.1346**, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- **Vendimi nr.1347**, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin, te Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”,

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (**Rregullorja**).
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
6. **Vendimi nr. 1345**, datë 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
7. **Vendimi nr.1346**, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
8. **Vendimi nr.1347**, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin, te Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Kërkesa Ankimore e “ATN” sh.p.k sh.p.k, për aktet administrative **nr.1345, nr.1346, nr.1347**, datë 23.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ankesa nr. 2 (**Ankim Administrativë**);
2. Vendim nr.1345, date 23.07.2010 të AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, (**Vendimi 1345**);

3. Vendimi nr.1346, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Vendimi 1346**);
4. Vendimi nr.1347, datë 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin, te Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Vendimi 1347**);
5. Projektvendim i KD te AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrative të, “ATN” sh.p.k, në lidhje me Aktet administrative, Vendimi nr.1345, 1346 dhe 1347 date 23.07.2010 (**Projektvendimi**);
6. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
si dhe,
7. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. “ATN” sh.p.k, brënda afatit ligjor te përcaktuar ne nenin 140 te ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ për ndryshimin e pjesëshëm dhe/ose shfuqizimin/revokimin të Akteve Administrative për Vendimin nr. 1345, 1346 dhe 1347 datë 23.07.2010 të KD të AKEP;
2. “ATN” sh.p.k me shkresën nr. 19/08 prot date 17.08.2010 (AKEP: nr. 2828 Prot, datë 19.08.2010) “Për shfuqizimi të Vendimeve nr. 1345, 1346 dhe 1347 datë 23.07.2010 të KD të AKEP” vlerësonë se, AKEP për vendimet nr. 1345,1346 dhe 1347 datë 23.07.2010 po monopolizon tregun.

Gjithashtu AKEP nëpërmjet Vendimit nr. 1345, 1346 dhe 1347 datë 23.07.2010, mbi ndryshimin e tarifave të terminimit me origjinim ndërkombëtar, ka favorizuar Operatorët FNT duke dëmtuar Operatorët Alternativë si dhe duke u mohuar këtyre të fundit të drejtën e marrjes së trafikut ndërkombëtar;

“ATN” sh.p.k, thekson se AKEP po demton konkurrencen e lirë dhe efektive si dhe po diskriminon barazinë në trajtimin e ofruesve të komunikimeve elektronike.

Për sa më sipër “ATN” sh.p.k kërkon shfuqizimin e Vendimeve nr. 1345, 1346 dhe 1347 datë 23.07.2010 të KD të AKEP;

3. Ankimi administrativë “ATN” sh.p.k, të më sipër cituar, në lidhje me VKD nr.1345, 1346 dhe 1347 date 23.07.2010, pezullojnë efektet e tij, nga data e depozitimit të ankimit në AKEP deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të AKEP mbi ankimin administrativë;
4. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativ mbi aktet administrative të Këshillit Drejtues të AKEP nr.1345, nr. 1346 dhe nr. 1347 date 23.07.2010 gjykon se:

- Në lidhje me terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare:

- **AKEP në arsyetimin e përdorur në VKD nr.1345, nr. 1346, nr. 1347 datë 23.07.2010**, në të cilët është vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare prej datës 1.11.2010 të jetë komerciale, është bazuar midis të tjerave në efektin që ka rregullimi i kësaj tarife në konkurrencën në tregjet me pakicë në Shqipëri;
- Në marrjen në konsideratë të këtij efekti AKEP, siç është arsyetuar dhe në vendimet e më sipër cituar është bazuar në:
- Përcaktimet e ligjit nr.9918, neni 42, pika 1-re e tij:

“AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë”;

- Rekomandimet e KE për tregjet përkatëse (rekomandimi i BE, 11.02.2003 për tregjet përkatës, pika 7 dhe rekomandimi i vitit 2007)¹, në të cilat theksohet se pikënisja për përkufizimin e tregjeve me shumicë është përkufizimi i tregjeve me pakicë të cilët janë tregjet e lidhur me ofertën dhe kërkesën e përdoruesve fundorë. Pas këtij përcaktimi të tregjeve me pakicë bëhet përcaktimi i tregjeve me shumicë që përfshijnë ofertën dhe kërkesën për shërbime të ofruara operatorëve me qëllim ofrimin e shërbimeve përdoruesve fundorë.
- Shërbimi i tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, sipas parimit të njohur “Pala Thirrëse Pagan” (Calling Party Pays-CPP)² është një shërbim që shërben si input për operatorët tranzitues për ta rishitur këtë shërbim duke e ofruar për operatorët e huaj për të realizuar thirrje të përdoruesve fundorë në keto shtete të huaja, pra me impakt direkt në tregjet me pakicë në shtetet e huaja. Efekti pozitiv në tregjet me pakicë në Shqipëri është vetëm indirekt, i cili është i varuar nga një sërë faktorësh të tjerë të cilët janë jashtë kontrollit të AKEP.
- **Vendimi nr. 1345**, date 23.07.2010, nuk heq të drejtën e operatorëve tranzitues për të terminuar thirrje hyrëse ndërkombëtare në AMC (apo detyrimin e AMC për të pranuar thirrje të tilla për terminim), por heq detyrimin për tarifë të rregulluar nga AKEP, pasi, megjithëse VKD nr.1345, datë 23.07.2010, në pikën 2/c përcakton se, *“Detyrimet e Albanian Mobile Communications per tarifen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare shfuqizohen. Heqja e ketyre detyrimeve behet efektive me 1.11.2010”*, në pikën 2/a, ky vendim përcakton detyrimin e AMC që *“te ofrojë terminim te thirrjeve hyrese derkombetare ne nivel shumice, per t’u rishitur nga operatorët e autorizuar*

¹ The starting point for the definition and identification of markets is a characterisation of retail markets over a given time horizon, taking into account demand-side and supply-side substitutability. Having characterised and defined retail markets which are markets involving the supply and demand of end users, it is then appropriate to identify relevant wholesale markets which are markets involving the demand of products of, and supply of products to, a third party wishing to supply end users.

nga AKEP". Pra vendimi lejon palët (AMC dhe operatorët tranzitues) të negociojnë tarifa të favorshme, ne baza komerciale dhe me përfitim reciprok;

- **Vendimi nr. 1346**, date 23.07.2010, nuk heq të drejtën e operatorëve tranzitues për të terminuar thirrje hyrëse ndërkombëtare në EM (apo detyrimin e EM për të pranuar thirrje të tilla për terminim), por heq detyrimin për tarifë të rregulluar nga AKEP, pasi, megjithëse VKD nr.1346, datë 23.07.2010, në pikën 1/c përcakton se, *Tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është objekt negociatash komerciale për thirrjet hyrëse ndërkombëtare ne piken 1/b, ky vendim përcakton detyrimin e EM që "te ofrojë terminim të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ne nivel shumice, për t'u rishitur nga operatorët e autorizuar nga AKEP"*. Pra vendimi lejon palët (EM dhe operatorët tranzitues) të negociojnë tarifa të favorshme, ne baza komerciale dhe me përfitim reciprok;
- Në lidhje me asimetrinë e tarifës së terminimit midis Vodafone/AMC dhe Eagle Mobile, AKEP sqaron se bazuar në arsyetimin e përdorur në VKD nr.1345, 1346 dhe 1347, datë 23.07.2010, tarifa e terminimit në vlerën 12.92 lek/minute dhe tarife 0.39 lek/per thirrje, duhet të fillojë të aplikohet nga data 24.07.2010;
- **Vendimi nr. 1347**, date 23.07.2010, nuk heq të drejtën e operatorëve tranzitues për të terminuar thirrje hyrëse ndërkombëtare në Vodafone (apo detyrimin e Vodafone për të pranuar thirrje të tilla për terminim), por heq detyrimin për tarifë të rregulluar nga AKEP, pasi, megjithëse VKD nr.1347, datë 23.07.2010, në pikën 2/c përcakton se, *"Detyrimet e Vodafone për tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare shfuqizohen. Heqja e ketyre detyrimeve bëhet efektive me 1.11.2010"*, ne pikën 2/a, ky vendim përcakton detyrimin e Vodafone që *"te ofrojë terminim të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ne nivel shumice, për t'u rishitur nga operatorët e autorizuar nga AKEP"*. Pra vendimi lejon palët (Vodafone dhe operatorët tranzitues) të negociojnë tarifa të favorshme, ne baza komerciale dhe me përfitim reciprok;

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 2828 Prot, datë 19.08.2010 të “ATN” sh.p.k për shfuqizimin e Vendimit nr. 1345, nr. 1346 dhe nr. 1347 datë 23.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë T:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**